



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0005630-11/26, dt. 10.02.2026

Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme në komunë dhe komiteve tjera; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore

1. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Komiteti i cëkur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 - 2.1 Arta Neziri
 - 2.2 Shkelqim Ibrahim
 - 2.3 Elfate Ademi Bahtiri,
 - 2.4 Ylli Veliu, dhe
 - 2.5 Festina Musliu
3. Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me nenin 4 të Rregullores Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteve të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë edhe kompetencat si në vijim:
 - 3.1 Promovon dhe krijon mundësi të barabarta, harton politikat e barazisë gjinore dhe ndërmerr aktivitetet për krijimin e mundësive të barabarta;
 - 3.2 Shqyrton para miratimit të gjitha aktet që i procedohen Kuvendit të Komunës në aspektin e barazisë gjinore;
 - 3.3 Bashkëpunon me Zyrën për Barazi Gjinore;
 - 3.4 Bashkëpunon me OJQ-të, të cilat janë aktive në fushën e barazisë gjinore;
 - 3.5 Punon në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazi gjinore.
4. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Komiteti për Barazi Gjinore i dorëzon Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës së tyre për shqyrtim dhe miratim.
6. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet: 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL-së

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Anëtarëve të komitetit